



Hamdi Mramori Street, No 1
Prishtina 10000 – Kosovo
Tel: +381 (0) 38 247 615 ext. 103
Fax: +381 (0) 38 247 620
e-mail: info@ero-ks.org
www.ero-ks.org

Prishtinë: 23 Maj 2007

Tarifat e rishikuara të propozuara nga ZRRE-ja për KOSTT SH.A-në

**(Përdorimi i sistemit të transmisionit, Çmimi i sistemit të
operimit dhe Çmimet e operimit të tregut)**

Të ardhurat e reduktuara

Ky seksion siguron maksimumin e të hyrave të lejuara që mbulohen nga KOSTT Sh.A-ja me çmime të lejuara. Kjo përputhet me të hyrat e lejuara të cilat më parë janë miratuar nga ZRRE për vitin 2007, prej €13,670,000, të përshtatura për të konsideruar shpenzimet aktuale të pakryera siç është paraqitur në letrën e KOSTT-it dërguar ZRRE-së më 10 maj 2007. Këto shpenzime të pakryera janë si vijon:

- Reduktimi në koston e personelit:
€150,000
- Reduktimi në koston e mirëmbajtjes:
€120,000
- Reduktimi në koston e blerjes së shërbimeve ndihmëse:
€10,000

Prandaj, reduktimi total që rezulton në të hyrat e lejuara për vitin 2007 do të jetë €480,000 dhe të hyrat e lejuara për tu mbuluar nga çmimet e TUOS për vitin 2007 do të jenë €13,190,000.

Të hyrat e KOSTT-it (duke përjashtuar shërbimet ndihmëse, blerjet e energjisë për të mbuluar humbjet e transmisionit dhe kostot e operatorit të tregut) janë zbutur gjatë një periudhe tre vjeçare nën mekanizmin e të ardhurave tavan (revenue-cap). Në përgatitjen e këtyre TUOS (Operatori i Sistemit të Transmisionit) të ndryshuara, KOSTT ka supozuar se të gjitha shpenzimet e pakryera për vitin 2007 do të mbulohen. Prandaj, ka qenë e nevojshme të rikalkulohen brenda periudhës së përshtatjes (faktori X) për të përcaktuar ndryshimet vjetore në të hyrat e lejuara në mënyrë që të sigurohet që KOSTT-i të mos tejkalojë apo mos t'i mbulojë të hyrat e lejuara gjatë periudhës tre vjeçare prej 2007 deri më 2009.

Tarifat për KOSTT Sh.A të propozuara nga ZRRE

Sipas udhëzimeve të aplikacionit të tarifave ky seksion ka për qëllim të sigurojë shpjegime se si azhurohen tarifat ekzistuese të rregulluara, në përputhje me të hyrat maksimale të lejuara për vitin e ardhshëm, siç janë kalkuluar në kërkesat e të hyrave.

Tabela 1 tregon se si tarifat e propozuara të ndryshuara krahasohen me ato që fillimisht janë miratuar nga ZRRE-ja për vitin 2007.

Tabela 1 – Çmimet TUOS të krahasuara

Infrastruktura e Pagesave		Originale	Të ndryshuara (siç janë propozuar)	Ndryshimi%
Të hyrat e lejuara të alokuara në infrastrukturën 20/400 kV	000 euro	2,773	2,690	-2.99
Të hyrat e lejuara të alokuara në infrastrukturën 110 kV	000 euro	3,308	3,209	-2.99
Totali i kërkesave të pagueshme për pagesën 220/400 kV	MW	37	37	0.00
Totali i kërkesave të pagueshme për pagesën 110 kV	MW	852	852	0.00
Infrastruktura e Pagesës				
- 220/400 kV*	Euro/kW/vit	3.119	3.025	-3.01
- 110 kV*	Euro/kW/vit	7.001	6.792	-2.99
Pagesa SO				
Të hyrat e lejuara të alokuara në SO	000 euro	1,492	1,447	-3.02
Shërbimet Ndhimëse	000 euro	1,385	1,175	-15.16
Humbjet (përfshirë humbjet e tranzitit)	000 euro	4,606	4,555	-1.11
Totali i pagesës së të hyrave të SO	000 euro	7,482	7,177	-4.08
Pagesa e kërkesës së pagueshme për SO (& OT)	GWh	8,581	8,455	-1.47
Pagesa e SO	Euro/MWh	0.872	0.849	-2.64
Pagesa OT				
Të hyrat OT	000 euro	115	115	0.00
Pagesa e OT	Euro/MWh	0.013	0.014	7.69
Totali i kërkesave të të hyrave për KOSTT-in	000 euro	13,678	13,190	-3.57

*Reshtat e hijezuar përfaqësojnë tarifat e rishikuara të transmisionit